




AKT THEMELIMI

I SHOQERISE 'HOTEL, RESTORANT, BAR ÇOBO' shpk

Fier, 18/09/2023



NENI 1

FORMIMI I SHOQERISE

Formohet Shoqeria me Përgjegjesi të Kufizuar, e themeluar nga Ortaket Z.Vladimir Çobo lindur me 05.08.1968 me nr ID:G80805015S; Z.Ismet Çobo lindur me 05.02.1962 me nr ID: G20207016M; Z.Agim Çobo lindur me 19.10.1965 me nr ID: G51019008L.

Emertimi tregtar i shoqerise do te jete "HOTEL,RESTORANT,BAR ÇOBO" sh.p.k. e cila ketu me posht ne kete kontrate do te quhet "Shoqeria"

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Qendra e Shoqerise do te jete ne Shqiperi, ne qytetin e Fierit, adresa juridike do te jete :Rruga "Levan" me nr pasurie 141/18; Zona Kadastrale 2436;Fier.

Gjithashtu Shoqeria mund te krijojë edhe dege , filiale apo agjensi te saj Brenda ose jashte teritorit te Republikes se Shqiperise.

NENI 3

KOHEZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një kohë pa afat. Ajo mund të shpërndahet para afatit me vendim të Ortakeve, dhe për shpërndarjen e saj e percakton vetë legjislacioni në fuqi.

NENI 4

ADMINISTRIMI



Shoqeria "HOTEL,RESTORANT,BAR ÇOBO" shpk ka si administrator Z.Vladimir Çobo.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i Veprimtarise se Shoqerise do te jetë:

- 1.Ofrimi I sherbimeve akomoduese per fjetje si hoteleri.
- 2.Ofrimi I shebimeve te kulinarise dhe ofrimi i ambienteve te pershtatshme per konsumimin e ushqimeve dhe pijeve te ndryshme.



NENI 6

KAPITALI

Kapitali themeltar do te jete ne shumen 100.000 leke, e cila duhet te depozitohet ne Banken Raiffeisen dhe do te çelet llogaria e Shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqerise "Hotel, restorant, bar Çobo" shpk eshte 100.000 (Njeqind mije) leke dhe i perbere nga 3 kuota sipas kontributit te ortakeve si me poshte:

- 1.- Z.Vladimir Çobo, kontribon ne shumen 34.000 (tridhjete e kater mije) leke te cilat perfaqsojne 34% te kapitalit themeltar dhe qe perbehet nga kontributet ne para ne shumen 34.000 (tridhjete e katermije) leke qe do te depozitohen ne Banken raiffeisen ku shoqeria do te cele llogarine e saj likuiduese.
- 2.- Z. Ismet Çobo kontribon ne shumen 33.000 (tridhjete e tremije) leke te cilat perfaqsojne 33% te kapitalit themeltar dhe qe perbehet nga kontributet ne para ne shumen 33.000 (tridhjete e tremije) leke qe do te depozitohen ne Banken Raiffeisen ku shoqeria do te cele llogarine e saj likuiduese.
- 3.- Z.Agim Çobo kontribon ne shumen 33.000 (tridhjete e tremije) leke te cilat perfaqesojne 33% te kapitalit themeltar dhe qe perbehet nga kontributet ne para ne shumen 33.000 (tridhjete e tremije) leke qe do te depozitohen ne Banken Raiffeisen ku shoqeria do te cele llogarine e saj likuiduese.

NENI 7

ADMINISTRIMI

Administrimi i Shoqerise do te behet nga nje administrator i vetem, person fizik, me detyren e te cilit palet bien dakort te ngarkojne Z.Vladimir Çobo, per nje periudhe nje vjecare duke filluar nga data e regjistrimit te Shoqerise, i cili e pranon kete detyre.

Organi vendimor i Shoqerise do te jete Asambleja e Ortakeve e cila do te mbidhet dhe do t'i marre vendimet sipas percaktimeve qe do te behen ne statutin e shoqerise, si dhe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 8

VLEFSHMERIA E KONTRATES

Kjo kontrate mund te priset prej seciles nga palet perpara afatit te percaktuar ne nenin 3 te saj, pasi te jete paraqitur me pare kerkesa me shkrim e pales tjeter, nga pala qe kerkon prishjen, te pakten gjashte muaj me pare.

Prishja e kesaj kontrate nuk eshte kusht i domosdoshem per prishjen e Shoqerise, e cila mund te vazhdoje ekzistencen e saj edhe me nje ortak te vetem.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARVESHJEVE

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin per zbatimin ose interpretimin e kesaj kontrate, palet do te perpiqen ti zgjidhin ne mirkuptim midis tyre, por ne rast se nje gje e tille do te behet e pamundur ato do te zgjidhen duke i u drejtuar gjykates se faktit te rrethit Fier.

NENI 10

Persa nuk eshte parashikuar ne kete kontrate do te zbatohen rregullat e percaktuara ne Statutin e Shoqerise, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Kodit Tregtar dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Hartuar ne Fier

Me daten 18/ 09 / 2023

Ne kater kopjo origjinale.

O R T A K E T

Vladimir Çobo



Ismet Çobo



Agim Çobo

